



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.07 Date 17/06/ 2010

Per

Miratimin e propozimit Bordi Kullimit - AUB Mat – Komunat Zejmen e Milot per vazhdimin e projektit te sistemimit te rrjedhes lumore ne zonen e ndaluar per shfrytezim sipas vendimit te K.K.Ujit nr. 09 date 30.08.2007.

Ne mbeshtetje te nenit 8,14,20,38,,46 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit “Mbi proçedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve”, Vendimit te K.K.Ujit nr.09 date 30.08.2007 pika 1 ”Per shfrytezimin e zhavorreve dhe te rerave ne zonat me rrezik permbytje ”Keshilli i Basenit Ujembledhes Mat,

V e n d o s i:

-Miratimin e propozimit te paraqitur nga AUB Mat ne mbeshtetje te vendimit te K.K.U. nr.09 dt.30.08.2007 per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Mat pika 1 ”Per shfrytezimin e zhavorreve dhe te rerave ne zonat me rrezik permbytje, sipas studimit te paraqitur nga Bordi Kullimit Lezhe dhe AUB Mat Lezhe dhe kerkesave te komunave Zejmen dhe Milot me perparesi zonen e Milotit, ku rrjedha e lumit po demton argjinturen ne anen e fshatit Pllane si dhe rrugen nacionale Lezhe - Rreshen ,

-Subjekteve te licensuara per shfrytezim te inerteve me impiante afer kesaj zone, te ju afrohet mundesia e pare per zbatimin e ketij projekti,

- Siperfaqja e shfrytezimit $S=0,8 \times 0,05=0,04 \text{ km}^2$.

- Kordinatat e zones se shfrytezimit jane si me poshte:

1. Zona mbi uren e trenit ne Milot ne nje gjatesi 800 ml gjeresi $t=50 \text{ m}$ me keto distanca orientuese: 20 ml nga rruga nacionale tek ura, 200 ml nga impianti i “Dejvis” shpk dhe 50 ml nga rruga nacionale tek ura e trenit Milot.
2. Projekti i miratuar me vendimte K.B.U.Mat nr.01 dt.20.09.2007 u shqyrtua dhe u la perseri ne fuqi per zbatim ne periudhat pa reshje dhe me nivele te ulet te ujit ne lum.
3. Subjektet qe do te aprovohen per shfrytezim do te ngarkohen me rehabilitimin e zones nga ana e Milotit.

4.Volumi i parashikuar per shfrytezim $v=120.000 \text{ m}^3$.

- Ky vendim hyn ne fuqi mbasi te njoftohet M.M.P.A.Ujrave Tirane.

PERGJEGJESIA U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

